

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVACMë
Dana

27 - 04 - 2018

P.nr. 3198/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren, Hysnije Gashi si dhe me
zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDACTED] me
vendbanim në rr. [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i
trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së
Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.949-7/16 të dt. 14.12.2017, duke vendosur
lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë,
gjykata me dt.13.02.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.949-7/16 të dt. 14.12.2017, dhe kjo
gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri

[REDACTED] me vendbanim në rr. [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur me
[REDACTED], nga i ati [REDACTED] i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të
letnjoftimit [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.06.2016, rreth orës 10:30, në Ferizaj, duke levizur në rrugën “
B.G.Sylejmani”, përkatshisht te pompa “Berisha Petroll”, duke drejtuar automjetin e
markes “Fort Kuga” me targa të regjistrimit [REDACTED] duke vepruar në kundërshtim
me dispozitat e nenit 46/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia duke mos i dhënë përparsi kalimi
mjetve tjera apo pjesmarrsve tjerë të komunikacimit e godet në derën e pasagjerit të anës
së djathtë automjetin e markes “VW Golf” me targë të regjistrimit [REDACTED] të cilin e
drejtonte [REDACTED] me të cilin raste pos dëmve materiale lendime të lehta

trupore pëson, [REDACTED], lëndime këto të pershkruara në ekspertizën mjeko ligjore të datës 08.12.2017,-

Me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurit, me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1(një) ditë burg.

Ë dëmtuara [REDACTED], me venbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.949-7/16 të dt. 14.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] nga rr. [REDACTED], Komuna Ferizaj, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.949-7/16 të dt. 14.12.2017,

me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: ekspertiza e ekspertit te komunikacionit e datës 21.11.2017, ekspertiza mjeko-ligjore te datës 08.12.2017, deklarata e te pandehurit dates 07.06.2016 deklarata e te demtuarit e dates 07.06.2016 si dhe fotografitë te cilat gjenden ne shkresat e lendes vendosi si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

E dëmtuara [REDAKTUAR], me vendbanim ne fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaqanik, per realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen ne kontest civil .

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


DIVIZIONI PENAL

P.nr.3198/17 dt.13.02.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtari i vetem gjykues,

Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit
të njëjtës gjykatë.